



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

19519

UDHËZIM I POSAÇËM
Nr. 24 , Datë 24/12/2017

20.12.17

“PËR
ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2018”

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 34 të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, i cili ende nuk ka hyrë në fuqi, për të siguruar një proces normal të zbatimit të buxhetit të buxhetit vjetor;

UDHËZ O J :

1. Nëpunësin e Parë Autorizues të kryejë detajimin e buxhetit vjetor 2018 për të gjitha institucionet e qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë, si dhe me anë të shkresave për shpenzimet korrente.
2. Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë, të kryejë pagesa vetëm për:
 - a. Pagesat për shërbimin e borxhit;
 - b. Pagesat për shpenzime emergjente spitalore me funksion jetësor (blerje oksigjen, gjak, ushqim, etj);
 - c. Pagat e punonjësve të qeverisjes së përgjithshme dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
 - d. Transferrat në Institucionin e Sigurimeve Shoqërore për pagesat e pensioneve;
 - e. Pagesë paaftësie/ndihma ekonomike/pagesë papunësie;
 - f. Pagesat për ushqim dhe medikamente për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme që e ofrojnë një shërbim të këtij lloji.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Arben Ahmetaj

